

BIBLIOTEKA

E

398

244

SHTETIT

GJIROKASTËR

**HIDHE
VALLEN
LUMA
E KUQE**

**Këngë
popullore**

39
244.

HIDHE
VALLEN,
LUMA
E KUQE



Këngë popullore
të mbledhura në Lumë
nga
Kamber Zela

HIDHE VALLEN, LUMA E KUQE

- Radio Kukësi jep lajmërimë,
se do t'bahen kudo ndërtime,
se do t'bahen projektura,
kinema e shpi kulture.
- 5 Ku do t'jetë parku i pushimit?
Buzë liqenit me ujë t'Drinit.
Lum për brezat që do t'vijjnë,
do t'shohin Kukësin si do t'ndrijë!
Tunde vallen, Luma e kuqe,
- 10 se po bahet Kukësi nuse!
Shih sa shpejt po ndryshon vendi,
shihet parku, shndrit liqeni,
majë kodrës, përfund kepit,
ç'po gjelbron kodra e qytetit.
- 15 Shtrihet rruga bregut Drinit,
ja në liqe varka e peshkimit.

Kukës

VITET E DRITËS, VITET E PARTISË

- Vitet e dritës, vitet e Partisë,
erdhën n'prag me gjak t'vegjlisë,
zhdukëm terrin, thyem kanune,
prijmë në ballë të çdo furtune.
- 5 Nandë fshatra një ekonomi,¹⁾
me banorë mbi pesë mijë,
kazmë e pushkë fort shtrëngojmë,
nji pllamë tok' t'preket s'lejojmë.
N'dy anë t'prronit tarraca shkallore
- 10 e kudo, n'mal e bregore,
mbjellim hardhi e pemë frutore,
puna fort po na vjen n'dore.

Bicaj

1) Kooperativa bujqësore «Partizani» — Bicaj, e përbërë nga fshatrat: Canaj, Osmanaj, Mustafaj, Nangë, Bushat, Tërshenë, Gabricë, Kolesjan e Domaj.

USHTRI E POPULL JEMI NJI¹⁾

Qysh atë ditë që leu Partia,
leu për s'dyti gjith' Shqipnia.
Nji qëllim na ka bashkue,
socializmin me ndërtue.

- 5 Ushtri popull jem' bashkue
për nji qëllim jem' tuj punue.
Çdo anmik le ta di:
ushtri-popull jemi nji,
kazmën n'dorë malit e fushës,
- 10 synin pishë në thep të pushkës.
Për pa u shkri me gur e mal,
nuk e lshojmë kët' vend për të gjallë.

1) Kënduar në festivalin kombëtar folklorik të Gji-rokastrës të vitit 1978.

Shoku Enver gjithnji ka thanë:
N'grykë të pushkës anmiqtë na kanë,
15 kurse ne i kem' n'grykë të topit,
do t'i kallim n'flak' t'barotit.

Kukës

PËLLAMBË E ÇELIK

- Shqipnia ime,
e dashuna nanë,
Partia t'ka veshun
çelik për çdo pllambë.
- 5 Në fusha e male,
kudo kangë e valle,
bilbili ia thotë,
s'na tund erë e shqotë.
Gurgullon bjeshkëve
- 10 ujët si kristali,
djersa e klasës
lule vatani.
Me gjak e djersë
vadisim Shqipninë,
- 15 lart, atdhe, fitoret,
se Partia t'prin!

Bicaj

BESNIKMADHI I PARTISË PUNËS

Kanë marrë malet një hije t'ranë,
dhimbje e madhe ka ra n'kto anë,
gjysmështize u ngrit flamuri,
ka pushue zemra e një burri,
5 ka pushue zemra e një trimi,
loti del, na prek hidhnimi.
Hysni Kapo, një trim i rrallë
fjalurtë e zemërzjarrë,
vetëtimë shqiponja e luftës,
10 besnikmadhi i Partisë Punës.
Fjala e tij si shkam nër male,
zemrat dridhen, humbje e madhe,
Enver Hoxha ec ngadalë,
mban mbi supë një shok të rrallë,
15 shokun e dashtun, një shok lufte,
trimat mbajnë një trim mbi supë.

Ndonëse dhimbjen thellë e ndjejmë,
si gjithnjë, n'forcë do ta kthejmë,
I pavdekshëm kujtimi i tij,
20 lart më lart, moj nanë Shqipni!

Përbreg

ÇETËS SË LUMËS

Nantë shtator dyzet e tre,
na u formue çeta e re,
çeta e vogël me gjem¹⁾ prej Kuksi,
komisar Meriman Jakupi.²⁾

- 5 Po na vjen prefekti në Bicaj,
kërkon mbledhje për me ba,
po vjell vner për Partinë,
hem për çetën, hem për lirinë.
Atherë gjemtë fort janë shtërngue,
10 në Zbor të Nangëve³⁾ e kan' përgjue,
vranë prefektin në makinë
me gjithë shokët që n'krah po i rrijnë.
E jehona fort ushtoi,
gjer n'Korab ajo kaloi,